



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES**

**V E N D I M**

**Nr. 32, datë 24. 04. 2018**

**PËR**

**“PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË NISUR NGA AKEP  
ME URDHËR NR. 64, DATË 26. 03. 2018 “PËR VLERËSIMIN E NDRYSHIMIT  
TË KOHËZGJATJES SË VLEFSHMËRISË SË PAKETAVE TARIFORE  
CELULARE ME PARAPAGIM NGA 30 NË 28 DITË”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Ilir	Zela	Kryetar
2. Z. Alban	Karapici	Anëtar
3. Znj. Anila	Denaj	Anëtar
4. Znj. Ketrin	Topçiu	Anëtar
5. Znj. Klarina	Allushi	Anëtar

dhe sekretare zj. Ina Nuellari, në mbledhjen e datës 24.04.2018, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe Rregullores së Brendshme “Për Funkcionimin e Këshillit Drejtues të AKEP”, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr.7, datë 16.02.2017, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Përfundimi i procedurës administrative të nisur nga AKEP me Urdhër nr. 64, datë 26. 03. 2018 “Për vlerësimin e ndryshimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së paketave tarifore celulare me parapagim nga 30 në 28 ditë”.

**BAZA LIGJORE:**

1. Germa II) e nenit 8, neni 98, neni 99, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*ligji nr.9918/2008*);

2. Pika 2 dhe 3 të nenit 90 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” (*ligji nr. 44/2015*)
3. Rregullore e Brendshme “Për Funkionimin e Këshillit Drejtues të AKEP”, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr.7, datë 16.02.2017 (*Rregullore e Brendshme*);

## **K Ë S H I L L I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Urdhër nr. 64, datë 26. 03. 2018 “Për vlerësimin e ndryshimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së paketave tarifore celulare me parapagim nga 30 në 28 ditë” (*Urdhër nr. 64/2018*);
2. Relacioni i grupit të punës sipas Urdhër nr. 64/2018 mbi çështjen e trajtuar në procedurën administrative të nisur kryesisht nga AKEP (*Relacioni*);
3. Projektakti miratues – Vendim i Këshillit Drejtues për “Përfundimin e procedurës administrative të nisur nga AKEP me Urdhër nr. 64, datë 26. 03. 2018 “Për vlerësimin e ndryshimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së paketave tarifore celulare me parapagim nga 30 në 28 ditë” (*Projekt-vendimi*);

## **V Ë R E N se:**

I. *Rrethanat faktike:*

### **1. Nxjerrja e Urdhër nr. 64/2018:**

Duke marrë shkas,

- a) nga shfaqja e vazhdueshme dhe në rritje e shqetësimit të grupeve të interesit
- b) si dhe deputetëve të Kuvendit<sup>1</sup> lidhur me aplikimin nga operatorët celularë të kohëzgjatjes 28 ditore të vlefshmërisë së paketave tarifore celulare,
- c) si dhe nga qëndrimi i Autoritetit të Konkurrencës në Vendimin nr. 475, datë 21.09.2017 për “Mbylljen e Hetimit Paraprak në Tregun me Pakicë të Shërbimeve Celulare dhe Dhënien e Disa Rekomandimeve” për këtë çështje, me qëllim, mbrojtjen e interesit publik si dhe verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë nga ana e operatorëve celularë,

AKEP me Urdhërin nr.64, datë 26.03.2018, ngriti një grup pune për fillimin kryesisht të procedurës administrative për kryerjen e një analize sa më të plotë dhe të argumentuar për të vlerësuar nëse ka efekte negative për konsumatorin zbatimi i kohëzgjatjes 28 ditore i paketave tarifore celulare nga 30 ditore që ka qenë më parë.

### **2. Referimet e grupit të punës:**

---

<sup>1</sup> Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Për të përmbushur detyrën sipas Urdhër nr. 64/2018, grupi i punës i është referuar në mënyrë analitike historikut dhe rrethanave të lidhura me çështjen dhe konkretisht:

- a. Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 475/2017,
- b. korespondencës së AKEP me Autoritetin e Konkurrencës,
- c. përgjigjeve të operatorëve dërguar në AKEP,
- d. vlerësimit të kohëzgjatjes së paketave me parapagesë të ofruara nga vendet e rajonit,
- e. rastit të AGCOM (Autoriteti Italian për Garancinë e Komunikimit).

### **3. Kuadri historik i lindjes dhe ecurisë së çështjes, paraqitet:**

3.1 Ndryshimi i kohëzgjatjes së ofertave për shërbimet mobile për përdoruesit me parapagim:

- Sipërmarresi Albtelecom ka bërë ndryshimin e periudhës së përdorimit nga 30 në 28 ditë për 5 programet standard. Data e hyrjes në fuqi e ndryshimeve është 15.03.2016 dhe data e njoftimit në AKEP 17.03.2016.
- Sipërmarresi Telekom Albania ka bërë ndryshimin e periudhës së përdorimit nga 30 në 28 ditë për 5 programe standard. Data e hyrjes në fuqi e ndryshimeve është 21.03.2016 dhe data e njoftimit në AKEP 23.03.2016.
- Sipërmarresi Vodafone Albania ka bërë ndryshimin e periudhës së përdorimit nga 30 në 28 ditë për 4 programe standarte. Data e hyrjes në fuqi e ndryshimeve është 23.03.2016 dhe data e njoftimit në AKEP 04.04.2016.

3.2 Korrespondenca e ndërsjelltë mes operatorëve dhe AKEP:

3.2.1 Sipërmarresit Albtelecom dhe Telekom Albania kanë raportuar në AKEP përmes modulit online brenda afatit të përcaktuar në Rregulloren nr.27, date 21.09.2012 (neni 8), ndërsa Vodafone Albania ka njoftuar 9 ditë pas afatit të përcaktuar në Rregullore.

3.2.2 AKEP me shkresën Nr.899 Prot., datë 03.05.2016, ka kërkuar informacion nga tre operatorët celularë për ndryshimin e kryer në kohëzgjatjen e ofertave 30 ditore.

3.2.3 Përgjigjet e operatorëve në mënyrë të përmbledhur janë:

- Vodafone Albania ka kthyer përgjigjen për informacionin e kërkuar nga AKEP me shkresën nr. Reference LRD/0069/OX, datë 10.05.2016, nëpërmjet së cilës sqaron se:
  - Bazuar në nenet 53 -54 të Ligjit 9918, përsa kohë që këto produkte dhe shërbime ofrohen në mënyrë transparente për publikun dhe AKEP dhe nga ana tjetër janë në përputhje me parimet bazë të ofrimit të shërbimeve publike sipas përcaktimeve të autorizimeve që Vodafone Albania disponon, Vodafone gëzon lirinë ekonomike për të vendosur përveç të tjerave kohëzgjatjen dhe kushte të tjera për paketat/ofertat që hedh në treg;
  - Përcaktimi i kohëzgjatjes së ofertave diktohet nga dinamika e tregut, ku në varësi të ndryshimeve të tregut, shtohet ose hiqet njëri apo tjetri element i përmbajtjes së paketës/ofertës, zgjatet ose reduktohet periudha e përdorimit të paketës/ofertës etj. Përpara se ndryshimi të zbatohet, Vodafone merr në konsideratë nevojat e

konsumatorëve, feedback-un e tyre dhe padiskutim interesat tregtare të kompanisë dhe fitimin e pritshëm;

- Zbatimi i praktikës prej 28 ditë për paketat/ofertat është një qasje në industrinë e BE-së për telekomunikacionet, duke përmendur rrjetet Vodafone në Europë, por edhe operatorë të tjerë në vende si Italia, Gjermania, Spanja, Rumania, Australia, të cilat e kanë gjerësisht në zbatim periudhën prej 28 ditë. Gjithashtu, përveç kësaj diferenca ditore mes muajve pas-sjell shpesh konfuzion te konsumatorët dhe në disa raste kompleksitet në faturim;
  - Vodafone ofron minuta ndërkombëtare në paketat e tij dhe njëkohësisht është munduar të absorbojë kostot e rritura të trafikut dalës ndërkombëtar.
- Telekom Albania ka dërguar informacionin e kërkuar nga AKEP me shkresën nr.2830/1, datë 10.5.2016, ku shprehet se:
- Tregu me pakicë është tashmë një treg i rregulluar dhe i monitoruar nga ana e AKEP dhe produktet dhe ofertat e shoqërisë Telekom Albania nuk bien ndesh me aktet rregullatore të rregullimit. Telekom ofron në paketat 4-javore sasi minutash/SMS drejt deri 30 destinacioneve ndërkombëtare. Kostot e interkoneksionit ndërkombëtare janë rritur 5-10 herë për vendet e jashtë BE-së. Por në mënyrë që pajtimtari të ketë të njejtat përfitime përveç atyre ekzistuese, duke filluar nga data 21 Mars, të gjitha paketat standarte përfshijnë 100 SMS kombetare/ ndërkombëtare, shtesë e dhënë si bonus për klientët;
  - Praktika e zbatimit të vlefshmërisë 28 ditore (4 javore) përdoret gjerësisht nga operatorët mobile në nivel Industrie. Ofertat dizajnohen për t'iu ofruar pajtimtarëve mundesi sa më të mira komunikimi si në bazë të kërkesave të abonentëve ashtu dhe kushteve, dinamikave dhe konkurencës në treg.
- Albtelcom ka dërguar informacionin e kërkuar me shkresën nr.4605/1, datë 12.5.2016, me anë të së cilës sqaron se:
- Nuk ka asnjë kufizim ligjor apo rregullator që vendos kufij minimale apo maksimale të afatit të vlefshmërisë së ofertave dhe paketave të telefonisë celulare. Është vënë re se në treg ka paketa/oferta me afat 1-ditor, 7-ditor, 14-ditor dhe 30-ditor dhe në plotësimin e formulareve në modulën online, afati i vlefshmërisë i referohet termit ditë. Gjithashtu, prej kohësh Albtelcom ka vërejtur që termi 28 ditë apo 4 javë përdoret gjerësisht në vende të ndryshme të Europës, si Itali, Gjermani apo Spanjë;
  - Në zbatim të plotë të dispozitave ligjore të Ligjit nr. 9918/2008, përcaktimet e Rregullores Nr. 27 datë 21.09.2012 si dhe Rregullores Nr. 31, datë 26.12.2013, Albtelcom mori masat për njoftimin paraprakisht të abonentëve duke publikuar informacionin mbi ndryshimin;
  - Në lidhje me interesat e pajtimtarëve Albtelcom shpreh bindjen se paketat e tij përmbushin më së miri kërkesat dhe përfitimet e përdoruesve dhe shpesh njësitë që përfshihen në to nuk arrijnë të konsumohen të gjitha. Gjithashtu përveç këtyre ofron dhe një sërë paketash me ulje deri në 50%.

3.2.4 Secili nga operatorët në sqarimet dhe/ose njoftimet e dërguar në AKEP lidhur me këto ndryshime ka përfshirë edhe informacion në lidhje me linkun në faqen e Internetit të tyre ku

është bërë publikimi si dhe mjetet e informimit publik ku është bërë njoftimi i ndryshimeve, detyrime këto që përcaktohen në Rregulloren nr. 27, datë 21.09.2012 mbi "Publikimin e informacionit për tarifatat si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektrortike publike". Për ndryshimet e cituara dhe njoftimet përkatëse AKEP ka dhënë informacion AK nëpërmjet shkresës Nr. 879/1 Prot., datë 03.05.2016.

Autoriteti i Konkurrencës ka zhvilluar një procedurë hetimore në përfundim të së cilës Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar se ndryshimi i kohëzgjatjes së paketave standarde nga 30 ditë në 28 ditë bën që konsumatori të faturohet rreth 13 muaj në vit në vend të 12 muajve, duke çuar në një **rritje vjetore prej rreth 6.5% të buxhetit të shpenzuar nga konsumatori** për këtë shërbim.

Gjithashtu, KK ka vlerësuar se praktika e ndryshimit në kohëzgjatjen e paketave standarde nga 30 ditë në 28 ditë mund të prekë dhe tregje të tjera në fushën e telekomunikacionit si p.sh. interneti, telefonia fikse, paketat televizive, etj., gjë e cila do të shkaktojte probleme në terma të transparencës dhe krahasueshmërisë së informacionit për pajtimtarët e tyre në lidhje me tarifatat e aplikuara për shërbimet e ofruara nga operatorët në sektorin e telekomunikacionit. Për sa më sipër, KK i rekomandon AKEP-it, si organ rregullator i tregut të komunikimeve elektronike në kuadër të kompetencave të tij për mbrojtjen dhe garantimin e mirinformimit të konsumatorit kryerjen e vlerësimit të paketave 28 ditore dhe 30 ditore për të parë nëse ka efekte negative për konsumatorin.

#### **4. Ankesa drejtuar AKEP nga Qendra e Mbrojtjes Konsumatore:**

4.1 Pas njohjes me shkresën e protokolluar në AKEP me Nr.1088 Prot., Datë 7.04.2017, për informacion në lidhje me ndryshimet e tarifave të operatorëve celularë, vërehet se kërkesa nuk përmban detaje apo referenca në lidhje me ndryshimet e tarifave celulare për të cilat kërkohet informacion.

4.2 Në përgjigje të kësaj ankese AKEP ka dhënë shpjegimet në lidhje me ndryshimet e kryera nga tre operatorë celularë në periudhën 24 Mars – 4 Prill 2016, si më poshtë:

- Gjatë fundit të muajit Mars dhe fillimit të muajit Prill, Vodafone Albania, Telekom Albania dhe Albtelecom kanë kryer disa ndryshime në paketat tarifore standarde (*bundle*) me parapagim me afat 28 ditor (4 javor).
- Ndryshimet e kryera janë kryesisht me ulje të çmimeve të paketave nga Vodafone të shoqëruara me ulje të njësive të komunikimit të përfshira në paketa, dhe me rritje të çmimeve të paketave nga T-Albania dhe Albtelecom, të shoqëruara me rritje të njësive të komunikimit të përfshira në paketa. Një ndryshim i përbashkët nga të tre operatorët është heqja e Internetit pa limit (me shpejtësi të reduktuar) pas konsumit të sasive përkatëse në GB të përfshira në paketë me shpejtësi 3G/4G. Në disa paketa tarifore operatorët përdornin shprehjen, "Internet pa limit" por me shënimin se deri në X GB konsumi është me shpejtësi 3G/4G (mesatarisht 2-20 Mbps), ndërsa pas konsumit të sasisë X GB shpejtësia reduktohet ndjeshëm në rreth 256 kbps.
- Kjo praktikë njihet si "Fair Usage Policy" dhe aplikohet nga shumë operatorë rrjetesh celulare në Europë, me qëllim racionalizimin e përdorimit të aksesit broadband në Internet në rrjete celulare 3G/4G, pasi ky shërbim ofrohet pothuajse gjithmonë me

tavan konsumi (GB) në ndryshim nga Inteneti broadband në rrjete fikse ku nuk ka limite për konsum në pothuajse të gjitha paketat tarifore. Nga komunikimet me operatorët rezulton se shprehja “*Internet pa limit*” është hequr pasi krijon konfuzion te shumë përdorues, të cilët prisnin të konsumonin me shpejtësi të lartë Internet pa limit. Operatorët nuk kanë ndryshuar sasinë e përfshirë me shpejtësi të lartë 3G/4G por kanë hequr vetëm pjesën me shpejtësi të reduktuar. Pra nuk ka ndryshim në sasinë e GByte me akses broadband celular, por vetëm heqje të aksesit narrowband celular (me shpejtësi të ulët).

- Në lidhje me kuadrin ligjor, sqarojmë se AKEP është organ rregullator që mbikqyr zbatimin e Ligjit 9918/2008, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ndërsa zbatimi i Ligjit nr. 9902/2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve” është kompetencë e MZHETTS dhe Komisionit përkatës për Mbrojtjen e Konsumatorëve.
- Sipas ligjit 9918/2008 dhe kuadrit nën-ligjor të komunikimeve elektronike, AKEP mund të aplikojë rregullim të tarifave me pakicë në rastet kur sipërmarrësi është i përcaktuar me statusin me Fuqi të Ndjeshme në Treg (FNT) ose kur është përcaktuar si ofrues i shërbimit universal. Asnjë prej operatorëve celularë në Shqipëri (madje dhe në të gjitha vendet Evropiane) nuk ka status me FNT për shërbimet me pakicë, si dhe nuk janë të përcaktuar si ofrues të shërbimit universal. Në këto kushte, operatorët celularë kanë të drejtë të përcaktojnë vetë tarifën e shërbimeve që ofrojnë në treg dhe ato janë jashtë rregullimit nga AKEP. Pavarësisht se niveli i tarifave me pakicë të operatorëve celularë nuk është objekt rregullimi nga AKEP, operatorët celularë kanë detyrime për mos-diskriminim dhe transparencë të tyre.
- Sipas Vendimeve të AKEP me nr.2522-2526, datë 6.11.2014, të ndryshuara, operatorët celularë kanë detyrime për mos-diskriminim në tarifën e thirrjeve brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare (përfshirë sasinë e minutave brenda dhe jashtë rrjetit të përhira në paketa). Ndryshimet e fundit të kryera nga operatorët celularë dhe të cituara në këtë informacion, nuk janë në shkelje të këtij detyrimi pasi operatorët kanë zbatuar detyrimin e mos-diskriminimit në tarifën/sasitë e thirrjeve brenda rrjetit dhe drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare.
- Në lidhje me zbatimin e detyrimeve për transparencë të tarifave për informimin e konsumatorëve, sipas përcaktimeve të Ligjit 9918/2008 dhe Rregullores së AKEP me Nr. 27, datë 21.09.2012 “Mbi Publikimin e informacionit për tarifën si dhe kushtet e aksesit dhe përdorimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike”, operatorët celularë si të gjithë ofruesit e tjerë të shërbimeve të komunikimeve elektronike kanë detyrime për publikim të informacionit të ndryshimit të tarifave, apo kushteve të përdorimit të ofertave, si dhe njoftimit të AKEP për çdo ndryshim. AKEP me Rregulloren Nr. 27, ka vendosur rregulla shtesë për publikimin e informacionit për tarifën dhe raportimit në AKEP të tyre, si dhe ka ndërtuar një modul *on-line* ku operatorët bëjnë njoftimet e planeve të reja tarifore apo ndryshimeve të tyre.
- Në bazë të monitorimit të ndryshimeve të kryera, rezulton se operatorët celularë kanë kryer publikimin e informacionit, informimin e konsumatorëve dhe njoftimin në AKEP sipas përcaktimeve ligjore dhe nën-ligjore. Sqarojmë se ndryshimet janë për paketa tarifore me parapagim dhe nuk kanë prekur përdoruesit që kanë blerë paketat e



mëparshme para datave përkatëse të hyrjes në fuqi të ndryshimeve apo paketave të reja/të rikonfiguruar në çmim dhe sasi komunikimi të përfshira në paketa.

## 5. Kohëzgjatja e tarifimit nga Operatorët e rajonit

Nga monitorimi i faqeve të internetit të disa operatorëve që ofrojnë shërbime mobile në vendet e rajonit konstatohet se në vendet (Serbi, Mali i Zi, Maqedoni, Greqi, Kosovë, Slloveni) nuk aplikohen tarifa me kohëzgjatje 28 ditore (4javore) Aneksi bashkëlidhur.

## 6. Rasti Italian

Përgjatë periudhës 2016 – 2017 rezultoi se operatorët TIM, Eënd Tre, Vodafone dhe Fast Eëb, ndryshuan periudhën e tarifimit nga mujore në 4 javore, si rezultat Autoriteti Italian për Konkurrencën (AGCM) dhe Autoritetit Italian Garant për Komunikimet (AGCom) gjatë kësaj periudhe kanë ndërmarë disa procedura hetimore, në të cilat paraqesin shqetësimin se këta operatorë kanë kryer këto ndryshime pa pasur një informim/njoftim adekuat të konsumatorëve. Sipas AGCom, kjo sjellje ka sjellë pasoja negative tek konsumatorët, si për shembull: rritje e numrit të periudhave të faturimit gjatë vitit nga 12 në 13, dhe 8.6% rritje në koston e përgjithshme për konsumatorët.

Në linjë me proceset investiguese të AGCom, në Parlamentin Italian u propozua një ligj i cili synonte të ndalonte faturimin në periudha 28 ditore, dhe në 14 Nëntor 2017 Komisioni për Buxhetin në Senatin Italian aprovoi një amendim në dekretin ligjor nr.148/2017 i cili përcaktonte periudhën mujore të tarifimit (ose periudha shumfish mujore) për sektorët:

- Operatorët e telekomunikacionit;
- Operatorët e rrjeteve televizive, dhe;
- Ofruesit e shërbimeve elektronike të komunikimit.

Sipas ligjit të ri, të gjitha sipërmarrjet që bëjnë pjesë në sektorët e mësipërm, duhet të bëjnë përshtatjen e ofertave të shërbimeve të tyre në përputhje me këtë ligj brenda një periudhe 120 ditore.

Si rezultat i këtyre masave, sipërmarrësit e mësipërm ku bëjnë pjesë edhe operatorët e shërbimeve mobile kanë ndryshuar kohëzgjatjen e paketave të shërbimeve nga 4 javore (28 ditore) në mujore (30 ditore). Në vijim paraqiten disa nga operatorët që kanë kryer këto ndryshime gjatë periudhës Mars – Prill 2018:

1. Vodafone Italia,
  - Mobile: faturim mujor duke nisur nga **25 Mars 2018**;
  - Fisso: faturim mujor duke nisur nga 5 Prill 2018;
2. TIM Italia
  - Mobile: faturim mujor duke nisur **nga 5 Mars 2018**;
  - Fisso: faturim mujor duke nisur nga 1 Prill 2018;
3. WIND Italia
  - Mobile: faturim mujor duke nisur **nga 4 Prill 2018**;
  - Fisso: faturim mujor duke nisur nga 5 Prill 2018;

4. Tre Italia
  - Mobile: faturim mujor duke nisur **nga 24 Mars 2018;**
  - Fisso (3Fiber/ADSL): faturim mujor duke nisur nga 5 Prill 2018.

## **7. Ndryshimi i periudhës së tarifimit për shërbimet mobile me parapagesë nga ALBtelecom:**

Sipërmarrësi Albtelecom, ka hedhur në sistemin RevZone përditësimin e afatit të periudhës së tarifimit të ofertave në të cilin shprehet se duke filluar nga data 10.04.2018 ka rikthyer afatit 30 ditor të vlefshmërisë për paketat standarte:

1. Super 500
2. Super 700
3. Super 1000
4. Super 1300
5. Super 1900

Ndryshimi i afatit të vlefshmërisë nga 28 në 30 ditë është njoftuar edhe në faqen e internetit të Albtelecom dhe në media.

## *II. Analiza e fakteve*

### **1. Efektet financiare tek konsumatorët si rezultat i ndryshimit të periudhës së faturimit nga 30 ditore në 28 ditore:**

Duke analizuar efektin financiar të ndryshimit të periudhës së faturimit nga 30 ditore në 28 ditore, rezulton se ndryshimi i afatit në paketat tarifore standarde (*bundle*) me parapagim nga 30 ditore në 28 ditore nga operatorët e shërbimeve mobile Albtelecom, Telekom Albania dhe Vodafone Albania, ka sjellë efekte tek përdoruesit të cilët kryejnë rimbushje në mënyrë të vazhdueshme përgjatë periudhës vjetore, pa përjashtuar edhe efektet që mund të shkaktohen tek përdoruesit e tjerë të shërbimeve me parapagesë të këtyre paketave.

Mbi këtë bazë, në rastin e aplikimit të kohëzgjatjes 30 ditore të shërbimit të ofruar nëpërmjet paketave *bundle* me parapagesë, përdoruesi faturohet rreth 12.17 periudha në vit (365/30), ndërsa në rastin e faturimit 28 ditor, përdoruesit do të faturohet 13.04 periudha në vit (365/28), çka sjell një rritje të periudhës së faturimit me 7.14%. Po të marrim si shembull rimbushjen e një pakete shërbimi *bundle* me vlerë 1,000 lekë, nëse në rastin e faturimit 30 ditor përdoruesi do të paguante 12,167 lekë në vit, me ndryshimin e ri tashmë ai do të faturohet 13,075 lekë në vit, pra rreth 869 lekë më shumë.

### **2. Kuadri ligjor:**

- Ligji nr. 9918/2008 në pikën 1 të nenit 99 të tij përcakton “Sipërmarrësit sigurojnë lidhjen ose aksesin në rrjetin publik të komunikimeve elektronike, në bazë të kontratës që lidhet me pajtimtarët në zbatim të legjislacionit në fuqi...”



Në kuptim të kësaj dispozite ofrimi për pajtimtarët i shërbimeve të operatorëve celularë me cilësinë e sipërmarrësit sipas ligjit nr. 9918/2008, duhet të realizohet vetëm mbi bazën e një kontrate pajtimi sipas kushteve të parashikuara në këtë ligj dhe aktet rregullatore të nxjerra nga AKEP-i për këtë qëllim, pamvarsisht mënyrës së pagesës për shërbimet e përdorura, me parapagim apo paspagim.

Mënyra e pagesës si një nga elementët që parashikohet në kushtet dhe termat e përgjithshëm të kontratës së pajtimit nuk duhet të çenojë zbatimin e parimit të barazisë për pajtimtarët lidhur me të drejtat dhe detyrimet kundrejt përdorimit të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike të ofruara nga sipërmarrësit.

Gjithashtu referuar pikës 4 të këtij neni, në interpretim të zgjeruar konstatohet se sipërmarrësit kanë detyrimin e ofrimit të lidhjes së kontratës së pajtimit mbi baza mujore.

- Nëse analizojmë çështjen e kontratës së pajtimit nën këndvështrimin e faturimit, në nenin 106/3 të Ligjit parashikohet “pagesa fikse mujore për shërbimin”, si një element i domosdoshëm i përmbajtjes së faturës.

Kuadri rregullator nënligjor.

- Në analizë të akteve rregullatore, të nxjerra nga AKEP në bazë dhe për zbatim të ligjit organik, është miratuar Rregullore nr. 31, datë 26.12.2013 “Për termat e përgjithshme të kontratës së pajtimit për lidhjen dhe aksesin në rrjetin publik të komunikimeve elektronike” (*Rregullore nr. 31*).

Në kreun VI të të emërtuar “Çmimet, faturimi dhe pagesa e shërbimeve” Pika 5.2 sanksionon si element edhe “Vlerën e gjithë shërbimeve të përdorura gjatë periudhës së faturuar. Periudha e faturimit zgjat nga dita e parë deri te dita e fundit e muajit kalendarik.”

Po kështu në vijim të njohjes së periudhës për efekt të faturimit të muajit kalendarik, më pas në pikën 18/2 të këtij seksioni parashikohet “Të kërkojë dhe lëshojë faturë për pagimin e menjëhershëm të detyrimit dhe pagesa do të pasqyrohet në faturën e muajit në vazhdim, ose...”

***Për të gjitha arsyetimet dhe parashikimet e sipërcituara nga kuadri ligjor e rregullator, arrihet në konkluzione se:***

- Lidhur me periudhën e faturimit, AKEP ka përcaktuar detyrimin për sipërmarrësit që kjo periudhë zgjat nga dita e parë deri tek dita e fundit e muajit kalendarik. Nisur në këto përcaktime, për rrjedhojë, pamvarsisht mënyrës së pagesës që kryejnë pajtimtarët, sipërmarrësit duhet të garantojnë faturimin e tyre për shërbimet e ofruara, sipas këtyre kushteve ligjore dhe kuadrit rregullator në fuqi.
- Ligji dhe kuadri rregullator nuk ka përcaktime dhe nuk bën diferenca në trajtimin e pajtimtarëve në varësi të faktit që janë me parapagim, apo paspagim.
- Pra edhe për pajtimtarët që përdorin mënyrën e pagesës me parapagim, sipërmarrësit duhet të zbatojnë rigorozisht detyrimet ligjore lidhur me faturimin e shërbimeve.
- Brenda këtij konteksti ligjor dhe rregullator, duhet që afati i paketave tarifore standarde (*bundle*) me parapagim të ofruara nga operatorët e shërbimeve mobile

Albtelecom, Telekom Albania dhe Vodafone Albania, të përputhet dhe të garantojë zbatimin e afatit të faturimit mujor kalendarik dhe jo 28 ditor, siç dhe është aplikuar.

- Sipërmarrësit duhet të garantojnë trajtimin e barabartë të pajtimtarëve kundrejt rregullave të përcaktuara ligjërisht për faturimin, si dhe të krijojnë mundësinë e aplikimit të tarifave për shërbimet publike të komunikimeve elektronike, në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara në nenin 53 të ligjit nr. 9918/2008.

### III. Konkluzionet e grupit të punës:

#### 1. Masat e propozuara në përfundim të procedimit administrativ

Bazuar në:

- nenin 7 të Ligjit nr. 9918 datë 19.5.2008(i ndryshuar) “Për komunikimet elektronike në RSH”, sipas të cilit “AKEP nxit konkurrencën efiçente për sigurimin e rrjeteve dhe të shërbimeve të komunikimeve elektronike për të mbrojtur interesat e përdoruesve të shërbimeve elektronike”
- nenin 8 germa II ,AKEP mbikëqyr respektimin e kërkesave të ligjit për tarifën e shërbimit të komunikimeve elektronike të disponueshme për publikun dhe mer masat e nevojshme rregullatore për zbatimin e këtij ligji;
- Nenin 53 pika 1 paragrafi fundit, “*në çdo rast sipërmarrësit duhet të shmangin përdorimin e tarifave abuzive, shpërdoruese dhe antikonkurruese*”.

Grupi i punës i propozon Këshillit Drejtues të AKEP marrjen e masës rregullatore për detyrimin e sipërmarrësve Vodafone Albania dhe Telekom Albania të rikthimit të vlefshmërisë së paketave standarte *bundle* të shërbimit celular me parapagim nga 28 në mujore(30 ditë).

### P Ë R K Ë T O A R S Y E:

**Këshilli Drejtues,**

pasi e gjen çështjen të trajtuar, të arsyetuar dhe përfundimtare nga grupi i punës sipas Urdhërit nr. 64/2018, në mbështetje të pikës 1 të nenit 114, pikës 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, Rregullores së Brendshme, si dhe në zbatim të pikës 2 dhe 3 të nenit 90 të ligjit nr. 44/2015,

### V E N D O S:

1. Miratimin e përfundimit të procedurës administrative të nisur nga AKEP me Urdhër nr. 64, datë 26. 03. 2018 “Për vlerësimin e ndryshimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së paketave tarifore celulare me parapagim nga 30 në 28 ditë.

2. Kohëzgjatja e vlefshmërisë së paketave tarifore celulare standard *bundle* me parapagim nga 28 ditë të jetë mujore(30 dite).
3. Detyrimin e sipërmarrësve e komunikimeve elektronike Vodafone Albania dhe Telekom Albania që duke filluar nga **data 1 qershor 2018** të rikthimit të vlefshmërisë së paketave standarte *bundle* të shërbimit celular me parapagim nga 28 ditë në mujore (30 ditore).
4. Sipermarresit Vodafone Albania dhe Telekom Albania të njoftojnë pajtimtarët për ndryshimin e paketave standarte nga 28 dite në mujore (30 ditore) të paktën 15 dite para hyrjes në fuqi të paketave standarte mujore (30 ditore).
5. Ky vendim do t'i njoftohet sipërmarrësve Vodafone Albania dhe Telekom Albania dhe do të publikohet në faqen e internetit të AKEP: [akep.al](http://akep.al)

Ky Vendim hyn në fuqi datën e miratimit të tij.

**K R Y E T A R**

**Ilir ZELA**

**ANËTARË:**

1. **Alban KARAPICI**
2. **Anila DENAJ**
3. **Ketrin TOPÇIU**
4. **Klarina ALLUSHI**